

SYLLABUS për lëndën FARMAKOLOGJI I(sem V)

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|----------------------------------|---|
| Njësia akademike: | Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë |
| Titulli i lëndës: | Farmakologji I |
| Niveli: | Mjekësi Veterinare |
| Statusi lëndës: | Obligative |
| Viti i studimeve: | Viti III, sem V |
| Numri i orëve në javë: | 3+2(45/30) |
| Vlera në kredi – ECTS: | 3 |
| Koha / lokacioni: | Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Dr.sc Mentor Alishani, Prof.asoc |
| Detajet kontaktuese: | Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë e-mail: mentor.alishani@uni-pr.edu cel: + 383 44 161 060 |
| Përshkrimi i lëndës | <p>Kjo lëndë do të siguroi instruksione në farmakologjinë bazike, indikacionet, masë përkujdese, dhe efekte të pafavorshme të barnave të etiketuara veterinare për trajtim të sëmundjeve të cilat i afektojnë kafshët. Do të prezantohet pasqyra tërësore e llojeve të medikamenteve që përdoren në trajtim terapeutik të sëmundjeve dhe çrregullimeve të ndryshme të organizmit. Temat që përfshihen janë: Zhvillimi historik dhe qëllimi i farmakologjisë. Burimet dhe natyra e barnave. Termet farmakologjike dhe definicionet. Principet e aktivitetit të barnave: Farmakokinetikët – Rrugët e administrimit të barnave, absorbimi, distribuimi, biotransformimi dhe ekskretimi i barnave. Farmakodinamika-koncepti barë dhe receptor, marrëdhënie dozë-përgjigje, termet që lidhen me aktivitet të barnës dhe faktorët që modifikojnë efektin e barnës dhe dozimin; reaksionet e pafavorshme të barnave, interakcioni i barnave. Barnat që veprojnë në sistem digjektiv: Stomahikët, antacidet dhe antiulçerët, prokinetikët, karminativët, antizimotikët, emetikët, antiemetikët, purgativët, antidiaroidikët, holereketikët dhe holagoguët. Farmakologjia e rumenit. Barnat me veprim në sistemin kardiovaskular: glikozidet kardiake, barnat antiaritmike, agjentë vasodilatorë dhe antihipertenzivë, koagulantët dhe antikoagulantët. Barnat me veprim në sistemin respirator: Ekspektorantët dhe antitusivët, stimulantët respirator,</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>bronkodilatorët dhe mukolitikët. Barnat me veprim në sistemin urogjenital: Diuretikët, alkalizuesit urinar, dhe acidifikuesit, terapia fluide. Farmakoterapeutikët të hormoneve dhe vitamineve. Barnat me veprim në lëkurë dhe membrana mukozale: Emollientët, demulcentët dhe kundër irritantët. Immunostimulantët dhe immunosupresantët. Në mes të temave të adresuara në ligjërata janë neurotransmisioni në ganglia dhe organe efektore, procesi rregullator i barnave, farmakologjia autonome veterinare dhe aplikimet praktike të anestezionit.</p> |
| <p>Qëllimet e lëndës:</p> | <p>Studentët familjarizohen me agjentë të ndryshëm farmakologjikë dhe për të kuptuar se si ata ndikojnë në pacient. Të kupton terminologjinë lidhur me këtë fushë. Të sjellë, shpjegon dhe aplikon parimet themelore farmakologjike. Rrit pajtueshmërinë e medikimit, zgjedhë problemet e administrimit të barnave, dhe implementon praktikat e terapisë me barna për përmirësim të shëndetit të kafshëve. To sjellë dhe aplikon indikacionet, kontraindikacionet, efektet e padëshiruara, interakcionin e barnave dhe kushtet e ruajtjes për grupet kryesore të barnave të aprovuara zakonisht të përdorur në trajtim të kafshëve shtëpiake. Të spjegojnë rreziqet për shëndet të njerëzve ndaj disa barnave veterinare.</p> |
| <p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p> | <p>Në përfundim të kësaj lënde, studentët do të fitojnë njohuri dhe aftësi me të cilat do të kenë ndikim pozitive në rezultate edukative, veterinare dhe ekonomike me zbatim të burimit të njohurive të barnave në operime me kafshë shtëpiake. Do të siguron instruksion në farmakologjinë bazike, indikimet, masë paraprake, dhe efekte të padëshiruara të barnave veterinare për trajtim të sëmundjeve të cilat afektojnë kafshët shtëpiake. Do të kenë njohuri edhe për çështje legale dhe rregullatore të cilat afektojnë përdorimin e përgjegjshëm të barnave si dhe njohuri mbi çështjen e sigurisë së ushqimit. Studentët zhvillojnë të kuptuarit të principeve me të cilat kemikalet afektojnë shëndetin e njerëzve dhe kafshëve ose dëmshëm, si agjentë toksikë ose dobishëm, si agjentë terapeutik.</p> |
| <p>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</p> | |

| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithësej |
|--|--|------------|-------------|
| Ligjërata | 3 h | 1/java | 3 h |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 2 h | 1/java | 2h |
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 3 h | 1/java | 3h |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiume,seminare | 1 h | 1/semestër | 1 |
| Detyra të shtëpisë | | | |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 3 h | 1 | 3 h |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 40 h | | 40 h |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final) | 1 h | 1 semestër | 1 h |
| Projektet,prezantimet ,etj | | | |
| Totali | 53 h | | 53 h |
| Metodologjia e mësimdhënies: | Metodat e mësimdhënies: Prezantimi I temave të selektuara në forma të ndryshme(Ligjërata, seminare dhe ushtrime) duke përdorur vegla të ndryshme për prezentim: Projektor, PowerPoint , material audio/video, demonstrim, përfshirë aktivitetin e studentit. | | |
| Metodat e vlerësimit: | Metodat e vlerësimit: test me shkrim në fund të kursit, vlerësimi i prezantimeve orale gjatë seminareve Provimi final | | |
| Literatura | <p>A.Rama, F.Selami. Farmakografia veterinare me baza të farmakoterapisë. Ed i parë. Pegi, 2011.</p> <p>Bassert JM, McCurnin DM. <i>Clinical Textbook for Veterinary Technicians</i>. 7th ed. St. Louis:Elsevier, 2010. Bill, R.</p> <p><i>Medical Mathematics and Dosage Calculations for Veterinary Professionals</i>, 2nd ed. Ames, IA:Wiley-Blackwell, 2009. Colville T, Bassert JM. <i>Clinical Anatomy & Physiology for Veterinary Technicians</i>. 2nd ed. St. Louis:Mosby, 2008. Colville T, Bassert JM. <i>Clinical Anatomy & Physiology Laboratory Manual for Veterinary Technicians</i>. St. Louis:Mosby, 2009.</p> | | |

| | |
|---------------------------|---|
| | <p><i>Veterinary Technicians</i>, 4th ed. St. Louis:Saunders, 2009. Supplemental/Recommended Textbook(s) and Materials:</p> <p>Allen DG. <i>Handbook of Veterinary Drugs</i>, 3rd ed. Ames, IA:Wiley-Blackwell, 2005.</p> <p>Plumb DC. <i>Plumb's Veterinary Drug Handbook</i>, 7th ed. Ames, IA:Wiley-Blackwell, 2011. Nefail Biba. Farmakologjia veterinare me bazat e toksikologjisë, ed i parë. Mokra, 2010.</p> |
| Literatura shtesë: | |

| Plani i dizajnuar i mësim: | |
|-----------------------------------|--|
| Java | Ligjëratat të cilat do të procedohen |
| <i>Java e parë:</i> | Hyrje në lëndë, kërkesat. Vendi dhe roli i farmakologjisë në edukim veterinarë. Definicioni i barnës. Farmakologjia e përgjithshme, Farmakodinamika: Veprimet e barnës e varur nga struktura dhe e pavarur. Interakcionet bar-receptor. |
| <i>Java e dytë:</i> | Lidhjet Dozë-përgjigje, konceptet terapeutike. Toksiciteti i barnës, faktorët që ndikojnë në toksicitetin e barnës, farmakokinetikët: Mekanizimi transportues i barnave, absorbimi, distribuimi. |
| <i>Java e tretë:</i> | Metabolizmi i barnës dhe ekskrecioni, modelimi farmakokinetikë, principet e farmakoterapisë. |
| <i>Java e katërt:</i> | Farmakologjia e detajuar Barnat me veprim në sistem nervor: Farmakologjia e Sistemit nervor autonom: Farmakologjia e Sistemit nervor parasimpatik(parasimpatomimetikët) Farmakologjia e Sistemit nervor parasimpatetik(parasimpatolitikët) Farmakologjia e Sistemit nervor simpatik(simpatomimetikët, simpatolitikët) |
| <i>Java e pestë:</i> | Barnat me veprim në Sistem nervor qëndrorë(SNQ): Barnat inhibitore të SNQ: Sedativët Trankilizues Hipnosedativët, Stimulantë të SNQ, Barna antikonvulzive |
| <i>Java e gjashtë:</i> | Farmakologjia e dhimbjes: Grupet e barnave dhe kategoritë: Agonist të receptorëve Opioid Antagonistë Opioid Neuroleptanalgesia Anestetikë Gjeneral: Anestetikët e injektueshëm |
| <i>Java e shtatë:</i> | Anestetikët Inhalator Anestetik lokal Barna miorelaksante qendrore dhe periferike |
| <i>Java e tetë:</i> | Farmakologjia inflamacionit: |

| | |
|------------------------------|---|
| | Mediatorët kimik të inflamacionit (caqet potenciale të trajtimit mjekësorë) BJAI-re tradicionale, ihibitor selektivë COX-2 Inhibitorët-Citokin, Antagonistë tromboksan, Inhibitorët - Leukotrinë |
| Java e nëntë: | Farmakologjia e histaminës Antihistaminët- H1 Farmakologjia e imunosupresionit Farmakologjia e glukokortikoidëve |
| Java e dhjetë: | Farmakologjia e sistemit kardiovaskular Farmakologjia e aritmive Farmakologjia e kontraktilitetit kardiak (inotropët pozitivë, barnat kardiotonike) Farmakologjiave rregullimit të volumit |
| Java e njëmbëdhjetë: | Barnat diuretike Farmakologjia e ton-it vaskularë Farmakologjia e haemostazës dhe trombozës |
| Java e dymbëdhjetë: | Farmakologjia e haematopoiesis dhe imunomodulimit Farmakologjia e sistemit respirator: Bronkodilatorët, barnat anti-inflamatore, barnat antitusive, mukolitikët dhe ekspektorantët Farmakologjia e astmës dhe KOPD |
| Java e trembëdhjetë: | Farmakologjia e sistemit digjektivë: Barnat emetike dhe antiemetike. Agjentë Prokinetik Barnat e ulcerës gastrike dhe duodenale. Barnat laksative, barnat antidiareale |
| Java e katërbëdhjetë: | Barnat Hepatoprotektive Barnat që afektojnë funksionin gastrointestinal tek ruminantët |
| Java e pesëmbëdhjetë: | Farmakologjia e gjëndrës tireoidale dhe hormonet e gjëndrës adrenale Hormonet Pankreatike, barnat që e influencojnë nivelin e glukozës në gjak Farmakologjia e hormoneve gonadale Barnat që afektojnë funksionin uterinë |
| Tema e praktikava | |
| Java | Ushtrimet që do të zhvillohen |
| Java e parë: | Burimet e barnave për përdorim në veterinar. praktika, klasifikimi & kategoritë e barnave |
| Java e dytë: | Distribuimi i barnave dhe shitja Trajtim i duhur, ruajtja dhe dispenzimi i barnave veterinare, farmacia |
| Java e tretë: | Emrat e barnave Farmakopea & Formularët |
| Java e katërt: | Format e përshkrimit Aspektet legale të përshkrimit të barnave |

| | |
|------------------------------|--|
| Java e pestë: | Format e forta të dozuara I. (pluhurat, granulat, premikset) |
| Java e gjashtë: | Format e forta të dozuara II. (tabletat, pillat, kapsulat, boluset, etj) |
| Java e shtatë: | Format gjysmë të forta të dozuara (Pomadat, kremat, pastat, linimentet etj.) Farmakologjia klinike(sedative) |
| Java e tetë: | Test-me shkrim |
| Java e nëntë: | Format e lëngëta të dozuara, aerosolët (solucionet, miksturat, emulsionet, injeksionet. etj.) Farmakologji klinike(hipnotikët, analgjetikët) |
| Java e dhjetë: | Njohuritë bazike mbi përgatitjen e barnave dhe dispenzim Inkompatibilitetet e barnave |
| Java e njëmbëdhjetë: | Hulumtim dhe zhvillim i përgatitjeve veterinare I. (Efikasiteti, ekzaminimet e sigurisë - me video prezantim) Farmakologjia klinike(anestetikët) |
| Java e dymbëdhjetë: | Test-me shkrim |
| Java e trembëdhjetë: | Hulumtim dhe zhvillim i përgatitjeve veterinare II. (Ekzaminimi farmakokinetik, Residuum) Principet e "Praktikave të mira"(GLP, GMP, GCP) |
| Java e katërbëdhjetë: | Regjistrimi i barnave veterinare, Praktika e mirë veterinare(PMV), Produktet e licencuara veterinare Farmakologjia klinike(agjentë nutritivë) |
| Java e pesëmbëdhjetë: | Vlerësimi i përgjithshëm i njohurisë praktike Si ti zgjedhim pyetjet praktike Konsultimet, diskutimi(hormonet, barnat miometriale) |

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Cakto politikat e mirësjelljes konfor statusit të UP-së.

Mbajtja e plan programit të prezantuar në sylabus, prezantimi i informacioneve shtesë, trajtimi i tematikave aktuale dhe emergjente.